



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.410-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Hidajete Gashi Alaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Labinot Halilaj, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL) të paraqitur kundër Shpalljes se Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Glllogoc dhe parregullsive gjate procesit zgjedhor, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 09.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. KORIGJOHET vendimi i PZAP-it ZL.Anr.410/2025 i datës 07.11.2025 ku në faqen e parë të dispozitivit të vendimit të PZAP-it, në pikën I. të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, do të duhej të ishte të paraqitur kundër Shpalljes se Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Glllogoc dhe parregullsive gjate procesit zgjedhor, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.

II. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.

III. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit ZL.Anr.410/2025, i datë 07.11.2025.

A r s y e t i m

PZAP-i duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Glllogocit, nga subjekti politik Për Drenasin Kampion me Ramiz Lladrovcin (PDKRLL), Labinot Halilaj, ZL.Anr.410/2025, e datës 05.11.2025, ka hedhur si të palejuar, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës sipas detyrës zyrtare ka konstatuar se në pikën –I- të dispozitivit ZL.Anr.410/2025 i datës 07.11.2025, ashtu që në faqen e I-rë, pikën I të dispozitivit të vendimit në rreshtin e katërt gabimisht është shënuar numri i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, e që do të duhej të ishte të paraqitur kundër Shpalljes se Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendin Komunal në Glllogoc dhe parregullsive gjate procesit zgjedhor, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.

Andaj duke ju referuar të cekurave më lart dhe duke u mbështetur në nenin 50 të Ligjit Nr. 05L-031 të LPPA-së, erdhi në përfundim se duhet bërë korrigjimi i vendimit të lartcekur, për arsye se është vërtetuar se është bërë gabim në shënimin e numrit të vendimit të KQZ-së.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.410-2/2025, datë 09.11.2025



Kryesues i Panelit,
Ramush Bardiqi

Këshilla Juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 4 i LZP-së.*